

VENDIM
Nr. 113, datë 13.2.2020

PËR KALIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË PUKË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PUKË, TË PASURISË 1/258, ZONA KADASTRALE 3069, ME EMËRTIMIN “GODINË 2 KATE ZYRA”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 359, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “a”, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin, në pronësi të Bashkisë Pukë, për Njësinë Administrative Pukë, të pasurisë 1/258, zona kadastrale 3069, me emërtimin “Godinë 2 kate zyra”, në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë, dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ushtrimin e funksioneve administrative të Bashkisë Pukë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Pukë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Bashkia Pukë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

HARTE KADASTRALE (Fragment)

AGJENCIA SHTETËRORE
E KADASTRËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë
Drejtor Andi PROKO

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 3069 NR.I PASURISË: 1/258 Vol 6 Fq 113

INDEKSI I HARTËS: PU-D-3 SHKALLA: 1:500

ADRESA E PASURISË: PUKË Q/F PUKË

Rr. HALIL TERBUNI P/G SH K AP

B. KUFIZIMET C. PRONARI

VERI: 1/660

JUG: 1/261

LINDJE: 1/415


PERENDIM: 1/655

SHTET
NË ADMINISTRIM SHËRBIMI
INFORMATIV SHTETËROR

Data: 06.12.2019

Ora:

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



LEGJENDË

1	X: 491812.9 m Y: 4656383.6 m	5	X: 491823.5 m Y: 4656349.8 m	9	X: 491834.8 m Y: 4656374.2 m	13	X: 491814.9 m Y: 4656353.9 m
2	X: 491837.2 m Y: 4656376.5 m	6	X: 491802.7 m Y: 4656356.0 m	10	X: 491829.2 m Y: 4656355.2 m	14	X: 491820.3 m Y: 4656371.9 m
3	X: 491830.0 m Y: 4656351.9 m	7	X: 491810.6 m Y: 4656382.5 m	11	X: 491823.1 m Y: 4656357.0 m	15	X: 491826.6 m Y: 4656370.0 m
4	X: 491824.6 m Y: 4656353.4 m	8	X: 491828.4 m Y: 4656376.1 m	12	X: 491821.6 m Y: 4656351.9 m		

1. FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

[illegible]